URDHËR
Nr. 608, datë 6.7.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në ligjin 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të RSH-së"; në nenet 22 e vijues të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; në ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; në ligjin nr. 162/2020, "Për prokurimin publik" dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 870, datë 14.12.2011, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit", i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së ministrit te drejtorit i përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, nga data 6–10 korrik 2026, për dërgimin me shërbim të punonjësve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme jashtë qendrës së punës, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në largësi mbi 100 km, si dhe me shërbim jashtë vendit.
2. Drejtori i përgjithshëm nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.
3. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Ferit Hoxha